

Llogari Rrjedhëse

Rishikoni termat, kushtet, tarifat dhe informacionet e rëndësishme që rregullojnë përdorimin e Llogarisë suaj Rrjedhëse në Jet Bank.

Çfarë është një llogari rrjedhëse (personale) në Jet Bank?

Një llogari rrjedhëse është llogaria bazë që përdoret për transaksionet financiare të përditshme, si marrja e fondeve, kryerja e pagesave, transfertat dhe përdorimi i kartës suaj. Ajo ju jep qasje të menjëhershme në fondet tuaja dhe shërben si llogaria kryesore për shërbimet bankare.

Në cilat monedha mund të hapet llogaria?

Llogaria mund të përdoret në monedhat e ofruara nga Banka, duke përfshirë Lekun Shqiptar (ALL) dhe Euron (EUR).

Çfarë informacioni duhet të vendos në dispozicion?

Ju duhet t'i jepni Bankës informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për identifikimin, verifikimin, burimin e fondeve dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore e rregullatore. Nëse informacioni mungon, është i pasaktë ose i paplotë, Banka mund të refuzojë ose të pezullojë shërbimet.

A duhet t'i përditësoj të dhënat e mia personale?

Po. Ju duhet të njoftoni Bankën pa vonesë për çdo ndryshim të të dhënave tuaja personale, si adresa, numri i telefonit, email-i, dokumenti i identifikimit ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për marrëdhënien bankare.

Si do të më kontaktojë Banka?

Banka mund t'ju kontaktojë përmes kanaleve të qëndrueshme të komunikimit, si aplikacioni, email-i, SMS-të, telefoni, internet/mobile banking, letra zyrtare ose kanale të tjera të përcaktuara nga Banka.

A mund të ndryshojnë kushtet, komisionet apo limitet?

Po. Banka mund të ndryshojë kushtet, tarifat, komisionet, limitet dhe shërbimet duke ju njoftuar të paktën 15 ditë kalendarike përpara se ndryshimet të hyjnë në fuqi. Nëse nuk jeni dakord, mund të kërkontë mbylljen e shërbimit përkatës brenda kësaj periudhe.

Sa zgjat kjo marrëveshje?

Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mbetet në fuqi derisa të ndërpritet nga ju ose nga Banka, sipas kushteve të marrëveshjes dhe ligjit në fuqi.

A mund të mbyll një produkt pa mbyllur plotësisht marrëdhënien time me Bankën?

Po. Ju mund të kërkonit mbylljen e një produkti specifik, si për shembull të kartës, pa mbyllur automatikisht llogarinë tuaj rrjedhëse ose produktet e tjera aktive. Nëse kërkonit mbylljen e të gjitha llogarive, marrëdhënia e plotë kontraktuale përfundon vetëm pasi të gjitha llogaritë të kenë bilanc zero dhe të gjitha detyrimet ndaj Bankës të jenë shlyer.

A mund ta ndërpresë Banka marrëdhënien me mua?

Po. Banka mund ta ndërpresë marrëdhënien në raste të tilla si: shkelja e kontratës, informacioni i pasaktë, përdorimi i paligjshëm i llogarisë, shkelja e kërkesave kundër pastrimit të parave, mashtrimi, evazioni fiskal ose raste të tjera të parashikuara nga ligji dhe rregullat e Bankës.

A janë të siguruara fondet në llogarinë time?

Po. Depozitat në Jet Bank janë të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) deri në shumën 2,500,000 LEK për çdo depozitues, në çdo bankë, sipas ligjit në fuqi.

Si mund ta mbyll Llogarinë time Rrjedhëse?

Për të mbyllur Llogarinë tuaj Rrjedhëse, duhet të kontaktoni Jet Bank përmes aplikacionit ose një kanali tjetër zyrtar komunikimi të Bankës.

Përpara mbylljes së llogarisë, Banka do të verifikojë nëse ka transaksione pezull, produkte aktive, komisione të papaguara ose gjendje mbetur të lidhur me llogarinë. Llogaria mund të mbyllet vetëm pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet përkatëse.